

**AKTI I THEMELIMIT**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**RS CONSTRUCTION & ENGINEERING SH.P.K.**  
**DATË 07.04.2021**

Sot, në datën 07.04.2021, ne te nënshkruarit:

- **Z. Roland SINJARI**, shtetas shqiptare, lindur më 08.11.1984, në Lushnjë, , banues ne adresën Tirane, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035787089, dhe me numër personal I41108079R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;

në cilësinë e Ortakut themelues, vendos të themelojë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar të emëruar "**RS CONSTRUCTION & ENGINEERING**" SH.P.K.. Aktiviteti i kësaj shoqërie do të kryhet në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, Aktin e Themelimit dhe Statutin e saj bashkëlidhur këtij akti si Shtojca A, i cili konsiderohet pjesë thelbësore e Aktit të Themelimit.

**Neni 1 – Emërtimi**

- 1.1 Shoqëria emërtohet "**RS CONSTRUCTION & ENGINEERING**" SH.P.K., (në vijim "Shoqëria").

**Neni 2 – Forma**

- 2.1 Shoqëria "**RS CONSTRUCTION & ENGINEERING**" SH.P.K themelohet në formën e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, dhe rregullohet prej këtij Statuti dhe Aktit të saj të Themelimit.
- 2.2 Shoqëria vepron në bazë të legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 3 – Selia**

- 3.1 Selia e Shoqërisë është në adresë "Ruga "Ndre Mjeda" Rezidenca "Alba", shkalla 5, kati i 2, apartamenti 3, Titane, Shqipëri.
- 3.2 Shoqëria mund të ketë zyra, degë, zyra përfaqësimi dhe agjenci si në adresë të tjera në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj.
- 3.3 Asambleja e Përgjithshme mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, degë dhe/ose zyra përfaqësimi dhe njësi vendore të çdo lloji. Ndërsa, Administratori i Shoqërisë mund të çelë, transferojë dhe/apo mbyllë, si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj, seli sekondare, filiale dhe/ose agjencive.



#### Neni 4 – Objekti

- 4.1 Shoqëria ka për objekt veprimtarie kryerjen e aktiviteteve të listuara më poshtë:
- Sherbime hotelerie, Qiradhenie, Bar-Restoran, Parkim, kend lojtrash, qender argetimi per femije te te gjitha moshave, qender per zhvillim te lojrade sportive dhe jo sportive, sherbime pastrimi (perfshire edhe lavazh automjete)
  - Investime ne fushën e pasurive te paluajtshme dhe ndërtimit;
  - Projektim, mbikëqyrje dhe zbatim i punimeve ndërtimore te çfarëdolloj.
  - Shitje, blerje, dhënie me qira e pasurive te paluajtshme;
  - Ofrimi i shërbimeve te konsulencës ne fushën e menaxhimit dhe marketimit te pasurive te paluajtshme;
  - Import-eksport te mallrave te ndryshme industriale, materiale ndërtimi, hidrosanitare, makineri te çdo lloji, si dhe shitjen dhe blerjen e tyre me shumice dhe pakice brenda dhe jashtë Shqipërisë.
  - Ndërmjetësimi për shitjen dhe marketimin e pasurive të paluajtshme dhe aseteve të ndryshme. Shërbime konsulencë në fushën e menaxhimit dhe marketimit të produkteve rezidenciale, komerciale... etj., dhe aseteve.
  - Aktivitete të vlerësimit të pronave dhe aseteve;
  - Shërbime marketing, marrëdhënieve me publikun, ekspertizë shitje, menaxhimi i pronës, ndërmjetësim qiradhënie, shërbime të studimit të tregut, shërbime të pas shitjes, njekja e pagesave të klientëve, mbajtja dhe menaxhimi i data bazës së klientëve, mbajtja e marrëdhënieve me klientët.
  - Veprimtari ekonomike në fushë e real estate (pasurive te paluajtshme). Negocime, ndërmjetësime, përfaqësime të të tretëve në fushën e real estate si në tregun e brendshëm ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Shitje, blerje, dhënie me qira të të gjitha llojeve të pasurive të paluajtshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe çdo transaksion tjeter në funksion të përbushjes së objektit të veprimtarisë në fushën e real estate, midis personave fizike, personave juridike private dhe publike si dhe nga shteti si dhe çdo veprim tjeter i ligjshëm që ka të bëjë me pasuritë e paluajtshme.
  - Shoqëria mund të kryej çdo operacion tregtar, e që lidhen me pasuri të luajtshme dhe te paluajtshme; operacione financiare dhe kredi marrje, të japë garanci të tretëve, si edhe të blejë dhe shes, ose marr me qira ndërmarrje, degë ndërmarrjesh, si dhe të ketë pjesëmarrje në shoqëri, ente, konsorciume të themeluara apo në themelim e sipër që kanë

objekt të njëjtë ose të ngjashëm me të vetin, por gjithsesi funksional për arritjen e qëllimeve të shoqërisë.

- I. Shoqëria mund edhe të japë garanci reale dhe/ose personale, të vendosë pengje, të dalë dorëzanëse apo të vendosë hipotekë edhe në favor të të tretëve.
- m. Gjithashtu, Shoqëria mund të kryejë çdo veprim apo operacion tjetër që ka të bëjë me pronën e paluajtshme, të luajtshme, çdo veprim apo operacion tjetër komercial, industrial e finansiar, të dobishëm apo plotësues ndaj përbushjes së objektit të Shoqërisë, me kusht që aktivitetet e mësipërme të mos jenë në kundërshtim me objektin e Shoqërisë.
- n. Tregtim me shumice e pakice, import-eksport i bimeve dekorative dhe luleve, i makinerive dhe i pajisjeve te ndryshme per kopshtari.
- o. Projektimi dhe zbatimi i veprave dekorative ne lidhje me kopshtarine dhe kopshtaret, si dhe cdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme.
- p. Aktivitet ne fushen e realizimit te veprave te infrastruktures si rruge, sistemime perfocuese-mbajtese, germime etj.
- q. Prodhim betoni
- r. Studimin,projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si:
- s. ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, Ujrale mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitese, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike.
- t. rikonstrukione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike;
- u. Vleresimin e pasurive te paluajtshme.
- v. Hartimi i raporteve te vleresimit te ndikimit ne mjedis, per te kryer auditimin mjedisor, per hartimin e ekspertizave per problem mjedisor.
- w. Veprimtari ne fushen e mbrojtjes nga zjarri te ndertesave te çdo lloji, hartimi i akteve te ekspertizes per zjarret e rena.
- x. Sherbim konsulence, studime urbane, sherbime ne planifikim urban, transporti, topografike, gjeologjike, hidrogeologjike, infrasrukture ambientale, projektim objektesh civile, arsimore, sportive, industriale, buqesore ushtarake, infrastruktura.
- y. Mbikqyrje dhe kolaudim punimesh.

- 8.2 Administratori/ët përfaqëson ligjërisht Shoqërinë. Administratori ushtron të gjitha fuqitë e administrimit të zakonshëm të Shoqërisë, në përputhje me nenin 95 të Ligjit nr.9901, datë 14 mars 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe çdo rast në zbatim të kufijve të përcaktuar në emërim dhe/ose në këtë Statut
- 8.3 Administratori/ët mund të emërojë përfaqësues me prokurë speciale ("*ad negotia*") për kryerjen e një akti ose kategoritë aktesh në kufijtë e tagrave që u janë dhënë atyre.
- 8.4 Personi i mëposhtëm caktohet si Administratori i parë i Shoqërisë:

**Z. Roland SINJARI, shtetas shqiptare, lindur më 08.11.1984, në Lushnjë, banues ne adresën Tiranë, madhorë dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 035787089, dhe me numër personal I41108079R, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;**

#### **Neni 9 – Gjuha**

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

#### **Neni 10 – Dispozita të Fundit**

- 10.1 Për çdo çështje që nuk rregullohet posaçërisht nga ky Akt Themelimi, do të zbatohen dispozitat përkatëse të legjislacionit shqiptar.

\* \* \*

Për

"RS CONSTRUCTION & ENGINEERING" SH.P.K.

  
Roland SINJARI  
ORTAK

07/09/2021